



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2022:283974  
Datë: 25.03.2024  
Numri i dokumentit: 05500876

**PPP.nr.241/22**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbaremore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, rr “Bulevardi Bill Clinton”, nr.5, kundër debitorit B.B.I. nga fsh ... Komuna e Ferizajt, me numër personal të Inj....., të cilin me autorizim e përfaqëson av Kemajl Ademaj, për pagesën e borgjit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga debitori, me datë 25.03.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.PRANOHET** pjesërisht prapësimi i të autorizuarit të debitorit B.I., i ushtruar kundër urdhrorit për përmbaremore P.nr.696/2022, i datës 13.12.2022, i lëshuar nga Përmbareuesi privat B.A. nga Ferizaj, sa i përket shumës së borxhit prej 6,423.26 euro të kërkuar nga kreditori në propozimin për përmbaremore, e cila rrjedh nga data 04.03.2014 e deri më datë 20.11.2021 dhe **SHFUQIZOHET** dhe **Lihet** jashtë fuqisë juridike urdhri për përmbaremore P.nr.696/2022, i datës 13.12.2022, sa i përket shumës së borxhit prej 6,423.26 euro, për shkak të parashkrimit.

**II.REFUZOHET** si i pabazuar prapësimi i të autorizuarit të debitorit B.I., i ushtruar kundër urdhrorit mbi lejimin e përmbaremit P.nr.696/2022, i datës 13.12.2022, i lëshuar nga përmbareuesi privat B.A., sa i përket shumës së borxhit prej 472.20 euro, borxh i cili rrjedh nga data 18.12.2021 e deri më datën 18.11.2022 dhe për shpenzimet e procedurës përmbaremore dhe **MBETET** në fuqi urdhri për lejimin e përmbaremit vetëm për shumën e borxhit prej 472.20 euro dhe për shpenzimet e procedurës përmbaremore.

A r s y e t i m

Me urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.696/2022, të datës 13.12.2022, përmbaruesi privat B.A., e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, kundër debitorit B.I., për pagesën e shumës së borxhit prej 6,887.51 euro, në bazë të ekstraktit të librave afariste me numër DFE ....., të datës 12.12.2022, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarimore, ose ndalimin e mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe nga xhirollogaria e debitorit të barten në xhirollogarinë bankare të përmbaruesit privat ose regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit i autorizuari i debitorit, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, duke i propozuar gjykatës që ta pranoj prapësimin dhe ta anuloj në tërësi urdhrin për përmbarim.

Kreditore ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e të autorizuarit të debitorit, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim.

Gjykata në këtë rast i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin mbi lejimin e përmbarimit dhe pretendimet në prapësim të autorizuarit të debitorit dhe vlerësoj se prapësimi është:

### **Pjesërisht i bazuar**

Në të vërtetë, Gjykata, me rastin e rishikimit të procedurës së përmbarimit, në bazë të nenit 43, par 4, të LPP-së, vlerësoj se urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.696/2022, i datës 13.12.2022, i lëshuar nga përmbaruesi privat B.A., është pjesërisht i ligjshëm dhe i rregullt, përkatësisht është i ligjshëm sa i përket shumës së borxhit prej 472.20 euro dhe shpenzimet e përmbarimit, kurse nuk është i ligjshëm sa i përket shumës së borxhit prej 6,423.26 euro, për shkak të parashkrimit.

Sa i përket pretendimeve të autorizuarit të debitorit në prapësim se: prapësimi i debitorit është i bazuar në dispozitat ligjore të nenit 360, të LMD-së, dhe kërkesa e kreditorit është parashkruar në mënyrë absolute, Gjykata këtë pretendim e konsideron pjesërisht të bazuar, ngase me rastin e shikimit të ekstraktit të verifikuar nga librat afariste DFE ....., gjykata ka konstatuar se faturat nga data nga data 04.03.2014 e deri më datë 20.11.2021, që kapin shumën e borxhit prej 6,423.26 euro, që nënkupton se janë fatura të cilat e kanë kaluar periudhën kohore prej një viti e paraparë me dispozitat e nenit 360, të LMD-së, pra janë fatura të cilat janë

parashkruar, vjetërsuar në bazë të nenit 360, par 1, nën par 1.1, të LMD-së, në të cilin është paraparë shprehimisht se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*. Për më tepër, pagesa prej 8.49 euro, e cila figuron në ekstraktin nga librat afariste, nuk është pagesë e bërë nga debitori por është pagesë e cila është bërë nga Qeveria e Republikës së Kosovës në emër të subvencionimit të energjisë, që nënkupton se kjo pagesë e cekur më lart nuk mund të interpretohet si pranimit i borxhit nga debitori dhe nuk janë plotësuar prezumimet e parapara në nenin 368, të LMD-së, që kanë të bëjnë me ndërprerjen e afatit të parashkrimit, ndërsa sa i përket faturave nga data 18.12.2021 e deri më datën 18.11.2022, që kapin shumën e borxhit prej 472.20 euro, janë fatura të cilat nuk janë parashkruar konform nenit 360, par 1, nën par 1.1, të LMD-së, ngase në bazë të propozimit për përmbaerim të kreditorit shihet se kreditori propozimin për përmbaerim e ka dorëzuar tek përmbaeruesi privat më datë 13.12.2022, që nënkupton se propozimin për përmbaerim kreditori, sa i përket shumës së cekur më lart të borxhit, e ka ushtruar brenda periudhës kohore prej një viti.

Gjithashtu, gjykata me rastin e llogaritjes së faturave të cilat janë parashkruar dhe faturave të cilat nuk janë parashkruar, të cilat janë sqaruar më lart, ka ardhur në përfundimin se shuma e borxhit prej 6,423.26 euro, është shumë e cila i përket faturave të cilat janë përfshirë në parashkrim, gjegjësisht periudha kohore e cila është përfshirë në parashkrim është nga data 04.03.2014 e deri më datë 20.11.2021, kurse shuma e borxhit prej 472.20 euro, për periudhën kohore prej datës 18.12.2021 e deri më datën 18.11.2022, është shuma e cila i përket faturave të cilat nuk janë të përfshira në parashkrim.

Si përfundim, Gjykata, duke i marr parasysh thëniet e të autorizuarit të debitorit në prapësim, përgjigjen e kreditorit në prapësimin e debitorit, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, përkatësisht e pranoj prapësimin e debitorit si të bazuar sa i përket shumës së borxhit prej 6,423.26 euro dhe për këtë pjesë të borxhit gjykata e shfuqizoj urdhrin për përmbaerim, për shkak të parashkrimit, kurse e refuzoj prapësimin e të autorizuarit të debitorit si të pabazuar sa i përket shumës së borxhit prej 472.20 euro dhe për shpenzimet e procedurës përmbaerimore dhe për këtë shumë të borxhit dhe për shpenzimet e përmbaerimit, gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri për përmbaerim.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, si dhe nenit 360, par 1, nën par 1.1, të LMD-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**PPP.nr.241/22, më datë 25.03.2024**

**GJYQTARI**

**Faton Ajvazi**

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimi të këtij aktvendimi.